

LETËR E HAPUR

NGA TË MBIJETURAT E TRAFIKIMIT

Sot në “Ditën Botërore Kundër Trafikimit”, ne të mbijetuarat e trafikimit, duam të ngremë më shumë zërin tonë dhe të flasim për të gjithë ato vajza, gra dhe fëmijë që janë të trafikuar apo të rrezikuar nga trafikimi dhe kanë frikë të flasin. Ne e dimë se çdo të thotë të jesh e vetme, e pambrojtur, e pashpresë dhe e paragjykuar, sepse i kemi përjetuar dikur vetë këto situata. Asnjëherë nuk e kemi humbur shpresën dhe falë edhe mbështetjes së Insitucioneve dhe disa organizatave ja kemi dale, duke mos u dorëzuar.

Ne, të mbijetuarat e trafikimit jemi të gatshme të bashkëpunojmë dhe të japim kontributin tonë për përmirësimin e situatës, prandaj sot ju drejtohem të gjitha insitucioneve që merren me mbrojtjen e viktimave të trafikimit me disa kërkesa dhe sugjerime:

- Puna për të luftuar trafikimin duhet të konsiderojë më shumë mbështetjen ndaj viktimave të trafikimit.
- Trafikantët duhet të marrin dënimin që meritojnë dhe të mos jenë më rrezik për të tjerët.
- Kërkojmë nga Policia, Prokuroria, Gjykatat dhe punonjësit e Insitucioneve të kenë më shumë ndjeshmëri dhe respekt ndaj viktimave të trafikimit.
- Të gjithë ne kemi nevojë për dikë që na beson, na mbron dhe na mbështet.
- Të drejtat tona mbrohen më mirë nëse nuk ka korrupsion në drejtësi.
- Duhet të trajtohem në mënyrë të barabartë dhe pa dallime.
- Kemi nevojë për mbrojtje dhe mbështetje psikologjike, mjekësore, ekonomike, ligjore, arsimore dhe siguri.
- Mendojmë se duhet të punohet më shumë për ndërgjegjësimin e atyre që janë të rrezikuar dhe që kanë nevojë të flasin dhe të dëgjoen.
- Shkollat duhet të jenë vendi i edukimit dhe rregullit, ku fëmijët të ndjehen të sigurtë dhe të mbrojtur.
- Gazetarët nuk duhet të bëjnë lajm me dhimbjen tone, por të na ndihmojnë me programet e tyre duke treguar realitetin në mënyrë që zëri ynë të dëgjoet.
- Të krijohen më shumë mundësi punësimi për ne, sepse duam të punojmë, që të mos jemi barrë e askujt.
- Insitucionet, shoqatat, shoqëria, familja dhe kushdo që mund të ndihmojë duhet t'i dëgjoni zërat e personave që kërkojnë ndihmë dhe duhet t'i mbron para se të bëhet vonë.

E kemi një thirrje edhe për vajzat, gratë dhe fëmijët, si dhe të gjithë ata që janë të rrezikuar nga trafikimi:

- Ka gjithnjë një derë për të trokitur dhe është dikush që ju dëgjon. Sigurohuni që po flisni me personin e duhur, ngrijeni zërin nëse nuk dëgjoeni, sepse ka njerëz të përkushtuar në Insitucione dhe Organizata që do t'ju mbrojnë.

Mos u dorëzoni kurrë para së keqes! Jemi me ju!

Firmat e personave qe kanë kontribuar:

